

## VENDIMET E BORDIT TË DATËS 25 QERSHOR 2019

### Vendimi Nr. 2019- 07K

#### Pjesëmarrja e Kryetari Rexhepi në AGM/ITF 2019

- Kryetari Rexhepi do të merr pjesë në AGM të ITF-it në Lisbonë, Portugali nga data 24-27 shtator 2019.
- FTK do të mbulojë kostot e transportit dhe te hotelit qe nuk mbulohen nga ITF.

### Vendimi Nr. 2019-24

#### Kriteri për përzgjedhjen e tenistëve për gara të përfaqësueseve

- Bordi me shumicë votash merr vendim që në garat e përfaqësueseve të grupmoshave U14, U16 dhe U18 (të tilla si European Junior Championships, European Summer Cup, etj), selektorët mund të përzgjedhin vetëm tenistët që kanë ranking minimal sipas tabelës në vijim:

Kategoria	Ranking minimal
U14	500 (Tennis Europe)
U16	600 (Tennis Europe)
U18	700 (ITF Juniors)

- Ky vendim hyn në fuqi nga viti 2020, dhe nuk vlen për turnetë për të cilat ka grant të plotë dhe specifike nga ITF, Tennis Europe, apo ndonjë palë tjetër.

### Vendimi Nr. 2019-25

#### Përgjedhja e vetëm një selektori kryesor

- Bordi merr vendim që të përzgjedhet vetëm një (1) selektor kryesor për të gjitha kategoritë.
- Nëse selektori për shkaqe objektive nuk mund të merr pjesë në një aktivitet apo turne të caktuar, ai/ajo mund ta delegojë atë aktivitet tek trajnerët e tjerë meritore.
- Ky vendim hyn në fuqi në momentin që kryeselektori emërohet, me ç'rast emërimet aktuale pushojnë.

### **Vendimi Nr. 2019-26**

#### **Eliminimi i K.T. Trepça nga Kampionati Ekipor 2019**

- Për shkak të mosparaqitjes së ekipit në xhiron çerekfinale sipas kalendarit, Bordi me shumicë votash merr vendim që K.T. Trepça të eliminohet nga Kampionati Ekipor 2019, rrjedhimisht K.T Prishtina kalon pa lojë në xhiron e ardhshme.

### **Vendimi Nr. 2019-27**

#### **Hapja e pozitës “Komisioner i garave”**

- Bordi merr vendim për hapjen e një pozite të rregullt pune me titull “Komisioner i Garave”. Komisioneri patjetër do të punonte gjatë fundjavëve me turne dhe gjatë ditëve të javës me orar fleksibil.
- Detyrat dhe përgjegjësitë do të hartohen dhe aprovohen nga Bordi në ditët në vijim, mirëpo përfshijnë së paku: përpilimin e kalendarit të garave, diskutimet me organizatorët për turnetë dhe reklamimin e tyre, procesim të rezultateve dhe publikim javor të rankingut.
- Të publikohet konkursi së pari në komunitet, e nëse kjo nuk ka sukses atëherë edhe jashtë tij.